



Logopädischer Dienst

Zhvillimi dhe trajnimi i gjuhës së fëmijës

Funksionet bazë për mësimin e gjuhës / të folurit

Zhvillimi i të folurit është më shumë se zhvillimi i gjuhës. Aty bëjnë pjesë të pamurit, të dëgjuarit, të prekurit, zhvillimi i përceptimit, zhvillimi i motorikës, zhvillimi i aftësive mendore dhe zhvillimi emotiv dhe social.

Që ta ndihmojmë zhvillimin e të folurit, do të thotë të formojmë një pasqyrë paraprake të zhvillimit të fëmiut në përgjithësi. Para se të fillojë zhvillimi i të folurit, zhvillohen gjërat bazë në pjesën e motorikës dhe përceptimit.

Sjellja jonë që e ndihmon zhvillimin e të folurit të fëmijës

Sjellja gjatë bisedës prind - fëmijë ndikon shumë në zhvillimin e të folurit: çdo fjalë apo fjali që e thotë fëmija duhet t'i kushtoni vëmendje, ta ndëgjoni dhe të reagoni në mënyrë të natyrshme.

Nëse sjelleni në këtë mënyrë gjatë bisedës me fëmijën, e ndihmoni atë shumë në zhvillimin e të folurit:

- *Kontakti me anë të syrit* *Fëmija e ndien veten se po e vëreni*
- *Vëmendje* *Fëmija e ndjen se ju po i kushtoni kohë, e lini të flasë, e ndjen veten që po e merrni me seriozitet*
- *Dëgjimi intenziv* *Ju jeni të interesuar në bisedën me fëmijën, i bëni pyetje lidhur me ngjarjen*
- *Përkrahje e vërtetë* *I dëgjoni dëshirat e fëmiut i kuptoni ato dhe i ofroni dashuri*

Shenjat e një ngecjeje në zhvillimin e të folurit

1. Vjeçar (0-12 muaj)
Fëmija belbëzon pak, heshtë më shumë, nuk reagon në zhurmë, nuk e kërkon kontaktin me sy.
2. Vjeçar (13-24 muaj)
Fëmija ende nuk i flet fjalët e para, komunikon me gjeste apo mimikë, nuk ju kupton. Edhe gjërat e mësuara nuk zhvillohen më tutje ose edhe harrohen.

3. Vjeçar (25-36 muaj)
Fëmija flet shumë pak fjalë (më pak se 50 fjalë), flet në mënyrë të pakuptueshme dhe nuk di të formojë fjali me dy fjalë.
4. Vjeçar (37-48 muaj)
Fëmija pyet shumë pak, flet pakuptueshëm për të huajt, nuk është në gjendje të formojë fjali. Të folurit e tij nuk përmban folje, gjini, shumës, mbiemra apo artikuj. Fjalori i tij përmban më pak se 100 fjalë.
5. Vjeçar (49-60 muaj)
Fëmija ka vështërsi të formojë fjali. Fjalitë që i formon kanë gabime gramatikore, nuk flet gjithnjë kuptueshëm, nuk është në gjendje të spjegojë një përmbajtje të thjeshtë..

Ngecje/pengesa në të folur

- Pengesa në të theksuar (Dyslalie)
- Probleme me formimin e fjalës dhe fjalisë (Dysgrammatismus)
- Fjalori i kufizuar
- Të kuptuarit e kufizuar
- Pengesa të përgjithshme për mësimin e gjuhës
- Pengesa në të folurit e rrjedhshëm si belbëzimi
- Pengesa të muskujve barazpeshës në pjesën e fytyrës
- Mutismus, të heshturit për shkaqe psikike

Si ta ndihmoni zhvillimin e të folurit dhe gjuhës

- Ju si prind jeni shembull në të folur, flisni ngadalë dhe pastër me fëmijën por jo në gjuhën e bebave.
- Përfshini fëmijën në aktivitetet e përditëshme dhe përcjellni ato me me fjalë (p.sh. gjatë përgatitjes së drekës, gjatë veshjes së rrobave e tjera).
- Mundësoni kontaktin me fëmijë të moshës së vet.
- Përmirësoni të folurit dhe gramatikën dhe pasuroni fjalorin e fëmijës tuaj duke e korigjuar dhe duke e mësuar.
- Zhvilloni dhe mbani dëshirën e fëmijës për të folur me anë të vjerrshës, këngës, lojës.
- Ritualet ditore përcjellni me këngë, vjerrshë apo lojë (p.sh. një lojë me gishta kur e vishni, një këngë kur e pastroni e tjera).

Logopädischer Dienst Glarus

Burgstrasse 30
8750 Glarus
www.gemeinde.glarus.ch

Astrid Rudolf Flach
Logopädin
Tel: 058 611 80 63
astrid.rudolf@glarus.ch

Holger Uhlig
Logopäde
Tel: 058 611 80 64
holger.uhlig@glarus.ch